



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:106587

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05426819

AA.nr.736/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A.H Komuna Klinës, përfaqësuar nga Xhevdet Krasniqi dhe Ilir Nikqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1292/2022 të datës 12.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1292/2022 i datës 12.07.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1292/2022 të datës 12.07.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit A.H, Komuna e Klinës. Në pikën II të dispozitivit e ka anuluar vendimin e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, nr.5606 i datës 01.04.2019 dhe vendimi i shkallës së parë i datës nr.5606 i datës 18.09.2018 dhe paditësit i njihet e drejta në kompensim për Persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Grupit të Parë. Në pikën III të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, që paditësit t’ia kompensoj pagesat në mënyrë retroaktive në emër të të drejtës në kompensim për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Grupit të Parë, nga data e paraqitjes së kërkesës 27.07.2018 deri në datën 12 korrik 2023, në shumë prej nga 375 (treqind e shtatëdhjetë e pesë) Euro për çdo muaj, deri në pagesën definitive,

duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8%, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor. Ndërsa nga data 13 korrik 2023 paditësi të paguhet në baza mujore në emër të të drejtës në kompensim për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Grupit të Parë, në shumën e cila aplikohet për këtë lloj pensioni dhe atë për periudhën pesë (5) vjeçare, deri më datën 12 korrik .2028. Në pikën IV të disozitivit ka vendosur që ky aktgjykim zëvendëson aktet administrative të anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar të prishet ashtu që të mbetet në fuqi vendimi Nr. 5606 i datës 01.04.2019.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin me nr. 5606 e dt.01.04.2019 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e z/nj. A.H, me numër të ID-së... për njohjen e të drejtës në kompensim për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik për arsye se nuk janë plotësuar kushtet ligjore.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.05.2022, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës vlerëson ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 43.3 të LKA-së dhe provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe ka gjetur se padia e paditësit është e bazuar. Gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se vendimi i kontestuar është nxjerrë ne me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë se: *“1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: Paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; Shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; Bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; Shkaqet për të cilat nuk*

është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; Në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt dhe kontradiktor ku është thënë: “Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, është vërtetuar se ankesa nuk është në harmoni me pikën 1 të nenit 8 të ligjit 05/L-067”, kurse vendimi është bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor të datës 20.03.2019 nga mjekë specialist të lëmisë përkatëse, të cilët kanë bërë ekzaminimin e dokumentacionit mjekësor të bashkangjitur në ankesë dhe ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, prandaj ankesën e refuzon si të pabazuar”. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit përgatitor, duke vërejtur gjendjen e rëndë shëndetësore të paditësit dhe pas propozimit të përfaqësuesit të paditësit, mori aktvendimin për nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, me ç’ rast ka obliguar QKUK-në që të caktojë ekspertët mjekësor të cilët do të hartonin ekspertizën mjekësore në bazë të dokumentacionit dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit. Gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12 korrik 2023, ka ftuar ekspertët mjekësor, me ç’ rast ekspertët mjekësor të pranishëm, Dr. V.S – Kirurg dhe Dr. B.A – Fiziatër - Anëtar, kanë sqaruar ekspertizën mjekësore, duke u përgjigjur në pyetjet e gjykatës. Në bazë të ekspertizës mjekësore të datës 13.03.2023, si dhe deklarimit të ekspertëve mjekësorë në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësi është pacient që hynë në kategorinë e personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, mirëpo që i njëjti për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme dhe atë 24 (njëzet e katër) orë, dhe në këtë gjendje ka nevojë për kujdesje dhe mbikëqyrje të vazhdueshme nga personi tjetër përcjellës. Ekspertët kanë theksuar se në bazë të diagnozave të paditësit e ka të pamundur të kryejë aktivitetet jetësore në mënyrë të pavarur, dhe kjo paaftësi është e plotë dhe e përhershme. Në këtë kuptim dhe në bazë të provave në shkresat e lëndës, konkretisht raporteve mjekësore dhe ekspertizës mjekësore të datës 13.03.2023, si dhe deklarimit të ekspertëve mjekësor në seancë, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi ka nevojë për kujdestar personal dhe atë për gjatë tërë kohës dhe vendosi se të njëjtit i takon grupit të parë të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Andaj, konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik i cili përcakton kriteret për përfitimin e kësaj të drejte, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se paditësit duhet t’i njihet kjo e drejtë dhe atë për periudhën prej datës së aplikimit. Pasi që gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar këtë fakt mbi bazën e dokumenteve mjekësore dhe ekspertizës së ekspertëve si dhe në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi, ka vlerësuar se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative pranë të paditurës. Duke marr për bazë këtë dhe konform nenit 43. par.3 të LKA-së, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar vetë gjendjen faktike edhe përmes ekspertizës mjekësore dhe ka konstatuar se vendimi kontestues është i kundërligjshëm. Andaj, si rezultat i kësaj ka vendosur që paditësit t’i njihet e drejta në kompensim për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, që nga data e aplikimit, ashtu që të njëjtit t’i bëhet kompensimi në mënyrë retroaktive, pasi që baza juridike e kërkesëpadisë është krijuar me anulimin e vendimit për ndërprerjen e kësaj të drejte. Duke qenë se paditësi i takon grupit të parë i njihet edhe e drejta në kujdestari, konform nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit 05/L-067. Lidhur

me lartësinë e shumës së pensionit për kompensimin në mënyrë retroaktive, gjykata e njohu të drejtën në përputhje me lartësinë e vlerës që zyrtarisht është përcaktuar për këtë kategori të personave tani e paditura. Pas kësaj date, paditësi do të gëzojë të drejtën në kompensim, ku për çdo muaj do të paguhet konform shumës së këtij pensioni si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka vendosur kur kërkesëpadinë e paditësit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë bazohet në ekspertizën e ekspertëve mjekësor të QKUK-së e cila ekspertizë është e mangët dhe e pa kjtartë si dhe e pa argumentuar, konfuze ku nuk japin skjarime në paaftësinë e tij dhe asnjë pikë te ekspertizës, gjë që të gjitha këto e bëjnë ekspertizën e mangët dhe të pa argumentuar. Tutje, Vlerësimet e komisioneve të MPMS-së janë bazuar në gjendjen e aftësisë së palës paditëse në vitin 2019 e jo në gjendjen e aftësisë që paditësit mund të ndryshoj Ekspertet e QKUK-së nuk mund të vërtetojnë gjendjen shëndetësore të paditësit në vitin 2019. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, meqë nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ është vërtetuar se paditësi i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar, e në veçanti nga ekspertiza mjekësore e datës 13.03.2023e mjekëve specialist të cilës gjykata e shkallës së parë me të drejtë ja fali besimin në tërësi, e cila është profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar, për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ. Pra gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate po ashtu nuk i aprovoi, për faktin se ekspertiza mjekësore është

e qartë dhe nuk ka kontradiktë në vete, si dhe e paditura nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re. Andaj, të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.736/2023, me datë 06.03.2024

kolegjit,

Kryetari i

Ramiz Kuqi